



ROLI I MBROJTJES SË MJEDISIT NË PROCESET EDUKATIVE

Riciklimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në kornizën e edukatës qytetare

Qëllimi i këtij projekti është pastrimi, edukimi dhe transformimi i mjedisve të përbashkëta, për të mundësuar ndryshimin e sjelljes së njerëzve lidhur me mbrojtjen e mjedisit, si dhe promovimin e kryeqytetit të turizmit, Durrësit tonë, për zhvillim të qëndrueshëm.

Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin për respektimin e mjedisit. Për më tepër, projekti fokusohet në mbledhjen, riciklimin, transformimin e plastikës në diçka të dobishme sikurse mjete shkollore, instalacione artistike e gjelbërim për komunitetin, reduktimin e plastikës; një çështje me rëndësi globale për mbrojtjen e ekosistemeve ujore nga plastika e patretshme nga natyra, veçanërisht mbrojtjen e bregdetit, detit dhe lumenjve, ku 11 miliard kg plastikë përfundojnë në oqean çdo vit. Shqipëria ka një ndër lumenjë më të ndotur në Evropë nga plastika, lumin Ishëm me 733,000 kg mbetje/vit, kryesisht plastikë, që derdhen në detin Adriatik, ndotje e ardhur kryesisht nga kryeqytetasit dhe 5 bashki, lumë që derdhet në Gjirin e Rodonit, zonë e mbrojtur, pjesë e Bashkisë Durrës, e cila përballet me ndotjen plastike dhe përfundon deri në brigjet e Kroacisë gjatë dimrit. Gjithashtu, plastika ka hyrë në zinxhirin ushqimor dhe sjell dëme në shëndetin e gjallesave, përfshirë njeriun.


Lëvizja vullnetare *River Cleanup Albania/Clean Ishëm River*, u themelua në qershor 2020 nga gjimnazistë vullnetarë, studentë, mësues dhe pedagogë nga qyteti i Durrësit, duke ndjekur *River-Cleanup.org*. Siç mund të jeni informuar edhe nga prania jonë në media dhe në rrjete sociale, në gjithë këto vite, ne jemi përfshirë në një numër veprimtarish në mbështetje të edukimit mjedisor dhe të riciklimit, realizuar së bashku me shkollat dhe universitetet, veçanërisht me shkollat e qarkut të Durrësit dhe me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), për zhvillimin e qëndrueshëm, për të ardhmen e Shqipërisë turistike, si dhe për të sjellë shpresën dhe besimin që në Shqipëri mund të jetohet në një mjedis të pastër e të bukur.

Edukimi Mjedisor dhe Riciklim përgjatë Vitit 2024

Me një buxhet prej **577,660 Lek** dhe shërbimet ofruar nga 16 kompani private, artistët, organizata, Shtëpia e Evropës, si dhe të ardhurat nga Riciklimi u realizuan për Vitin 2024:

1. 12 (dymbëdhjetë) aktivitete u realizuan **gjatë 2024, 9 (nëntë) për Edukim Mjedisor e Riciklim** në qendër të qyteteve Durrës dhe Tiranë, sikurse **Dita e Ujit, Tokës, Mjedisit, Dita Botërore të Pastrimit, Dita e Vullnetarizmit, Dita Kombëtare e Rinisë** etj, si dhe **3 (tre) Aksione Pastrimi** përgjatë bregdetit të Durrësit e Himarës- Porto Palermo, parkut natyror “Qafështamë” Krujë dhe zonën e mbrojtur Hamallë-Gjiri i Lalëzit, ku morën pjesë 2,850 vullnetarë, kryesisht nxënës nga 35 shkolla të Durrësit dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Aktivitetet u suportuan nga kompanitë private shqiptare sikurse: Electric.cars, Alb Uji, Resto_cafe_hotel_heming_way, Studio Parruca, Eco Soft Albania, noterja Aida Spahiu, artisti me fame botërore, violinist Olen Çezari.

2. U ricikluan si më poshtë sipas muajve të vitit 2024 **një sasi prej 4,318 kg shishe plastike si PET nga 2,850 vullnetarë, kryesisht nga Fëmijët e Rinia e Durrësit, duke mbledhur konsumin mujor-dy thasë me shishe plastike (uji, shampo, detergjentë) nga shtëpia drejt shkollës dhe UAMD-së, në shërbim të gjelbërimit, mjeteve sportive, didaktike dhe artit.**



3. Në muajin Nëntor 2024, u realizua një konkurs nga Shtëpia e Evropës në Shqipëri me 12 shkolla të rethit të Durrësit me në qendër sasinë e plastikës grumbulluar për Riciklim, shoqëruar edhe me promovimin e instalacioeve me tapa plastike:

Tre çmime u ndanë për tri shkollat që grumbulluan më shumë plastikë nga konkursi midis 12 shkollave u siguruan shtëpia e Evropës, ku fituan çmime çek kthyer në mjete shkollore: Çmimi i parë shkoi për shkollën "Marie Kaçuli" 500 €; Çmimi i dytë shkoi për shkollën "Bilal Golemi", Xhafzotaj 300 € dhe Çmimi i tretë për shkollën "Jusuf Puka" me 200 €. Fokusi i Konkursit midis 12 shkollave të Durrësit, organizuar me mbështetjen e "Shtëpisë së Evropës" (Europe House), në Shkollën 9-vjeçare "14 Nëntori", rikonstruktuar pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019, me mbështetjen e Bashkimit Evropian përmes programit "EU for Schools", u shpreh nga përfaqësuesi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Jean Bapstiste Le Bras, i cili inkurajoi veprimet e ndërmarra nga fëmijët dhe rinia e Durrësit : ***"Kemi jo vetëm godina të bukura, por edhe njerëz humanë brenda tyre, që ndërmarrin veprime për kohët ku jetojmë, sikurse mbrojtja e mjedisit nga plastika.... Më vjen keq që nuk mora edhe fëmijët e mi gjashtë dhe nëntë vjeç në këtë aktivitet kaq mbresëlënës e edukativ."***

12 shkollat e përfshira në konkursin për mbledhjen e plastikës, gjithashtu morën certifikata pjesëmarrëse nga zyra e BE-së Shqipëri për veprimet e tyre në mbrojtje të mjedisit, ku u panë me kërkues edhe instalacionet artistike të shkollave "Vinçenc Prendushi", "Bajram Curri", "Jusuf Puka", "Kushtrimi i Lirisë" etj., ku të pranishëm në aktivitet ishin edhe përfaqësues nga shtetet anëtare të BE-së. Morën pjesë 250 nxënës nga 12 shkolla 9-vjeçare. U mbledhën gjithsej 2,080 kg plastikë dhe u riciklua 1,655 kg prej tyre ose 80%, për t'u konvertuar në mjete sportive e çlodhëse për mjediset arsimore. Më poshtë gjejmë emrat e shkollave dhe kg përkatës.

1. Marie Kaçulini 520 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 430 kg
2. Bilal Golemi 380 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 190 kg
3. Jusuf Puka 190 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 190 kg
4. Po Qemal Mici 200 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 175 kg
5. 14 Nëntori 180 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 160 kg
6. Kushtrimi i Lirisë 140 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 110 kg
7. Vëllezërit Haradinaj 120 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 85 kg
8. Vinçenc Prendushi 100 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 75 kg
9. Bajram Curri 80 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 70 kg
10. Hasan Koçi 80 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 55 kg
11. Hafiz Ali Podgorica 60 kg plastikë e grumbulluar, e riciklueshme 60 kg

12. Hajdar Dushi 60 kg plastikë e grumbulluar, e ricikluar 55 kg

Objektivi ynë është të shtojmë plastikën e ricikluar, të nxitim ndarjen e saj në burim nga populli shqiptar për ekonominë qarkulluese, edukuar nga shkollat dhe UAMD dhe reduktojmë mbjetjet që shkojnë në landfill.

4. "Mbill pemën tënde!"-nisma e Rektorit të UAMD-së, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, në bashkëpunim me Kryebashkiaken e Durrësit, znj. Emiriana Sako dhe shkollat e Durrësit. Morën pjesë mbi 250 vullnetarë, ku secili mbolli pemën e tij, 100 rrënjë ulliri, 100 eukalipt, agrume dhe pemë frutore të tjera. Në fund të aktivitetit u ndanë certifikata për punën vullnetare nga Rektori i UAMD-së dhe u promovua arti me riciklim.

Gjthsej në 2024, 770 pemë e fidanë u mbollën, tapet bari gjelbëruan mjediset e shkollave dhe UAMD-së, qytetin e Durrësit, **në sajë të procesit të Riciklimit dhe bashkëpunimit me kompanitë private. 550 fidanë e pemë u mbollën në kampusin e UAMD-së,** sikurse mbi 170 rrënjë ullinj, mbi 120 eukalipt, mbi 70 pemë të larta rrap, agrume, plep e shkurre të tjera zbukuruese, kurse mbi **220 të tjera u mbollën në oborret e 35 shkollave të Durrësit.** Dy shkollave u siguroam edhe tapet bari.

Falenderojmë fidanishtet që na dhuruan pemë, fidanë dhe shkurre zbukuruese:

1. 100 Rrap Green Farm Albania
2. 52 shkurre zbukuruese Fidanishte_xhepi
3. 100 ullinj Agrofidane_Prenci
4. 70 agrume Fidanishte_saimir_shahu
5. 60 ullinj fidanishte_hushi
6. 50 shkurre zbukuruese Lule_natyrale_hida,
7. 63 shkurre zbukuruese Lule_natyrale_durimi,
8. tapet bari Tapet Bari-Vëllezërit Shehi
9. tapet bari tapet_bari_natyral_lushnje

525 fidanë e pemë dhe tapet bari për institucionet arsimore, prej tyre 312 mbjellur në kampusin universitar, ku 85% kanë zënë e kanë bërë kokrra sikurse ullinj e agrume.

4.1 Dy vepra arti në trajtë pemësh nga riciklimi i tapave plastike u vendosën pranë kampusit të UAMD-së, Fakulteti i Edukimit:

1. Vepra e artistit **"Pema e Jetës"** si bashkëpunim i artistes Malvina Dreni me shkollat dhe Universitetin e Durrësit. Punimi me 1000 tapa të shisheve dhe sipër me epoxy resine vendoset në Fakultetin e Edukimit, UAMD. *"Ne duam një Shqipëri të pastër dhe ta mbajmë të bukur siç është!" [#cleanishëmrivër](#) janë heronjtë e kësaj nisme kaq të bukur!"*-shprehet artistja e veprës Malvina Dreni.

2. Vepra e Artistit, **"Pema që ka rrënjë edukimin, fryt i një Shqipërie të pastër"**. *"Nis nga ne, mësuesit. Ne jemi rrënjët që mbjellim vlerat e edukatës dhe përgjegjësisë tek brezat e rinj, duke e pasuruar kështu shoqërinë me individë të edukuar dhe të ndërgjegjshëm. Edukimi, sikurse një pemë që ka rrënjë të thella, zhvillohet dhe rritet përmes ndikimit tonë si mësues, duke filluar nga vlerat themelore për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e plastikës, të cilat janë pjesë e një edukimi të përgjegjshëm për një të ardhme më të pastër."* -shprehet mësuesja virtuozë Marsida Mezja. "Ky punim me 5000 tapa nga unë, lidh edukimin dhe pastrimin e mjedisit me rolin e mësuesve si themelues të vlerave për një shoqëri të qëndrueshme."-vijon mësuesja Marsida Mezja e klasës Vc, shkolla "Bajram Curri, vepër arti që u vendos tek Fakulteti i Edukimit, UAMD.

"Falenderojmë nga zemra të gjithë vullnetarët, stafin akademik e administrativ, të rinjtë e UAMD-së, mësuesit nga shkollat e Durrësit që morën pjesë dhe fëmijët për përkushtimin dhe energjinë që sollën në nismën për pastrimin e vendit tonë! Me ndihmën tuaj, jo vetëm që kemi dhënë një shembull të shkëlqyer, por edhe kemi bërë një ndryshim të prekshëm për mjedisin dhe komunitetin tonë. Ju ftojme të gjithëve të tjerëve të bashkoheni në këtë nismë të bukur. Çdo hap, sado i vogël, kontribuon për një të ardhme më të pastër dhe më të shëndetshme për të gjithë ne. Bashkë mund ta ndërtojmë një mjedis më të mirë për brezat që vijnë. Faleminderit për mbështetjen dhe përkushtimin tuaj!"-shprehen studentët e UAMD-së, Infermierisë së Përgjithshme Fizioterapisë.

"Puna jonë vullnetare mjedisore u përqendrua në mbjelljen e pemëve dhe sensibilizimin për rëndësinë e një mjedisi të pastër në qytetin e Durrësit, duke përfaqësuar Universitetin "Aleksandër Moisiu". Me krenari ngritëm flamurin e universitetit tonë në rrugët e qytetit, si simbol i përkushtimit

tonë për një mjedis më të mirë. Gjatë udhëtimit me autobus me shishe plastike, ndonëse u përballëm me komente që na bënë të ndiheshim të ofenduar se mbanin thasë me shishe plastike, kjo nuk na demotivoi, por na shtyu të vazhdonim me më shumë pasion deri në Kampus. Pati dhe qytetarë që na falenderuan për pastrimin kur na panë me thasë me bidona dhe flamurin e UAMD-së. Ndjesia kur mbollëm pemët dhe krijuam ndikim pozitiv në komunitet ishte e papërshkrueshme dhe na mbushi me krenari. Falënderojmë Rektorin Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi për mbështetjen dhe për certifikimin e punës vullnetare.”- u shpreh studenti i Fizioterapisë, Dejv Kojtari.

4.2 Promovim i filmave në Shtëpinë e Evropës dhe Kampusin e UAMD-së:

Filmi për Ditën e Mjedisit-5 Qershor 2024: "Kokrrat e piperit dhe sekretet e detit të thellë", në Shtëpinë e Evropës. Sot bëjmë 4 vjeç dhe kemi zgjedhur të festojmë me Fëmijët në Shtëpinë e Evropës për të treguar se Evropa është në Shqipëri, duke theksuar se gjithçka në Shqipëri buron nga ajo që ushqejmë sot Fëmijët nga klasa e Parë dhe si vjen pastaj produkti qytetar deri në universitet nga ku lindi kjo qytetari, nga studentët e UAMD-së para 4 vitesh në bashkëpunim me River Cleanup e Bashkinë Durrës.

Filmi me metrazh të shkurtër “Dje dhe Sot”, në kampusin universitar me producente mësuesen virtuozë të ciklit fillor, Marsida Mezja. Një homazh i bukur për periudhën e çlirimit dhe ndryshimet që ndodhën pas tij. Ky film bazuar në filmin e mirënjohur "Tomka dhe shokët e tij" është një mundësi për të reflektuar mbi të kaluarën, duke treguar përpjekjet dhe sakrificat e atyre që kontribuan në çlirimin e Shqipërisë, si dhe për të pasqyruar zhvillimet e mëtejshme të shoqërisë shqiptare. Producente Marsida Mezja. **Viti 2024 shënon 80-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë,** një jubile historik që mbart një rëndësi të veçantë për çdo shqiptar. Në këtë kuadër, mësuesja virtuozë Marsida Mezja, e cila ka kontribuar gjatë gjithë jetës së saj në formimin e brezave të rinj, ka sjellë një risi të jashtëzakonshme: krijimin e filmit me metrazh të shkurtër “Dje dhe Sot”, një homazh i bukur për periudhën e çlirimit dhe ndryshimet që ndodhën pas tij. Ky film është një mundësi për të reflektuar mbi të kaluarën, duke treguar përpjekjet dhe sakrificat e atyre që kontribuan në çlirimin e Shqipërisë, si dhe për të pasqyruar zhvillimet e mëtejshme të shoqërisë shqiptare. Përmes këtij filmi, mësuesja ka arritur të nxisë reflektim të thellë mbi historinë, vlerat dhe sfidat që Shqipëria ka përjetuar pas Luftës, duke i ofruar publikut një perspektivë të freskët dhe të ndjeshme për ndikimin e ngjarjeve historike në jetën e përditshme. Ky projekt është një dhuratë e mrekullueshme për 80-vjetorin e Çlirimit, duke i bërë homazh jo vetëm atyre që luftuan për lirinë, por edhe për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kombëtare. Përmes angazhimit të saj, mësuesja ka sjellë një shembull të shkëlqyer të pasionit dhe përkushtimit ndaj edukatës dhe kulturës, duke i dhënë publikut mundësinë të vlerësojë më shumë historinë dhe të kuptojë më thellë ndikimin e saj në të tashmen.

5. U vendosën 5 kosha riciklimi, 2 pranë UAMD-së dhe nga një në gjimnazet “Leonik Tomeo” dhe “Naim Frashëri”, si dhe një në shkollën “Jusuf Puka”, blerë nga kompania private “Eko Energjia” dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal kur nisi riciklimi në 2022.

6. Leksione të Edukatës Qytetare-Mjedisore u mbajtën nga studentët e UAMD-së, dega Fizioterapi, viti i parë, kryesuar nga studenti Dejv Kojtari me kërkesë të mësuesve të Edukatës Qytetare në shkollat 9 vjeçare: Hafiz Ali Podgorica, Shkozet Bilal Golemi, Xhafzotaj dhe Vadardhë, Sukth.

7. Udhëtim me Anije për promovimin e bukurisë natyrore dhe historike: A) “Festë Deti 2024”shëtitje me rimorkiatorin “Epidamn” rreth bregdetit të Gjirit të Durrësit me më shumë se 100 të ftuar, organizuar nga shoqata "Durrësi Autokton". B) Udhëtim me Katamaran rreth Kalasë në Porto Palermos, suportuar nga violinisti durrsak me famë Botërore Olen Çezari.

8. Trashëgimi Kulturorë e vizituar, ku është realizuar pastrim: Kalaja në Porto Palermo, Himarë, organizuar nga artisti Olen Çezari.

9. Parqe natyrore të vizituara, ku është realizuar pastrim: Parku natyror “Qafështamë”, Krujë, organizuar nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura Durrës.

10. Aksion pastrimi në zonën e mbrojtur, Hamallaj në Gjirin e Lalëzit, organizuar nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura Durrës.

11. Mjetet shkollore, sportive, çlodhëse ardhur nga Riciklimi-Ekonomia Qarkulluese për vitin 2024, përfutur nga tetë institucione arsimore:

- Shkolla “Marie Kaçulini” bleu mjetin e dytë nga riciklimi: **videoprojektor** për ciklin fillor.
- Shkolla “Qemal Mici” bleu mjetin e dytë nga riciklimi: **videoprojektor**.
- Shkolla “14 Nëntori” bleu mjetin e dytë nga riciklimi: **vazo me lule për shkollën e re**.
- Shkolla “Hajdar Dushi” me të ardhurat e Riciklimit **ndërtoi bibliotekën** e munguar, duke e transformuar një klasë në bibliotekë.
- Shkolla “Bilal Golemi”, Xhafzotaj, bleu nga riciklimi **mjete mësimore dhe sportive**: 2 topa futboll, 1 top volejboli, libra për kopshtin e shkollës, atlase për nxënësit, realizoi 5 pako (fletore shkrimi, matematike, vizore, gome, ngjyra, laps, stilolaps, priefse) për nxënësit me aftësi ndryshe.
- Shkolla “Jusuf Puka” përfitoi nga Riciklimi mjetin e 3-të shkollor nga riciklimi: **mjete mësimore dhe sportive**: 2 topa volejboli, 3 loje mos u nxe, 3 raketa tenisi, 2 loje shahu, 2 loje domino, 1 boks muzike, 2 pako shkronja manjetike per kopshtin, 1 shtëpi formuese për kopshtin, 1 pako topa pingpongu.
- Shkolla “Marie Kaçulini” përfitoi nga Riciklimi mjetin e 3-të shkollor: **mjete mësimore dhe mjete për më të vegjlit-kopshtin**: (8 vizore të mëdha gjeometrie, trekëndor, raportor) dhe mjete kopshti, 5 pako bojëra druri, 10 fletore vizatimi, 1 lojë mësimore për kopshtin, 2 përralla formuese për kopshtin, 1 pazëll formues për kopshtin, 1 shtëpi formuese për kopshtin, 1 pako lojë me birrila për kopshtin, 2 pako numratorë druri. Përveç kësaj shkolla ka përfituar 2 ngrohëse për fëmijët e dy grupeve të kopshtit nisur nga kërkesat e edukatoreve, pasi edhe pse kemi ngrohje me kalidaj dhe jemi furnizuar me pelet nga Bashkia Durrës, fëmijët e vegjël kanë nevojë për një mjedis më të ngrohtë.
- Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës përfitoi një mjet sportiv-fushë pinpongu për studentët në kampusin universitar si dhe gjelbërim, ku transporti i plastikës u realizua falas nga Bashkia Durrës.

[#MbillPemënTënde](#)

[#Vepro#shkëndija](#)

[#përedukimmjedisor](#) [#riciklim](#)

[#nisjangavetja](#)

[#nukështëturtptëregoshqytetari](#)

[#mjedisijemiNE](#)

[#uamd](#)

[#shkollatedurrësit](#)

[#cleanishemriver](#)

[#RiverCleanupAlbania](#)

[#cleanlocally](#) [#celebrateglobally](#)

Link-e të fageve sociale të aktiviteteve:


<https://www.instagram.com/cleanishemriver/#>

<https://www.facebook.com/cleanishemriver>

<https://www.river-cleanup.org/en/project/ishem>
















	Total	Vullnetarë	Kg Plastikë-PET	Kg Plastikë në landfill	KG Mbetje të tjera në landfill	Total KG
Aktivitete për Edukim Mjedisor dhe Riciklim në qendër të qyteteve, pranë shkollave dhe UAMD-së	9	2,645	4,318	0	0	4,318
Aksione Pastrimi pranë lumit dhe bregdetit, parqeve natyrore	3	205	0	760	860	1,620
Aktivitete për 2024	12	2,850	4,318	760	860	5,938
Shkolla të Edukatës Mjedisore	35	7 mjete shkollore u siguruan nga të ardhurat e Riciklimit për shkollat më aktive në Edukim Mjedisor me Veprime për 2024: Marie Kaçulini 2 herë, Qemal Mici, 14 Nëntori, Bilal Golemi, Hajdar Dushi dhe Jusuf Puka.				
UAMD, udhëheqës i Edukatës Mjedisore dhe Ekonomisë Qarkulluese	1	Një tavolinë pinpongu u sigurua nga riciklimi për kampusin universitar.				
Shkolla në Konkurs nga BE në Shqipëri për Riciklimin	12	12 shkolla u certifikuan nga BE, 3 çmime për mjete shkollore u siguruan për shkollat që mbledhën e ricikluan: Marie Kaçulini, Bilal Golemi, Jusuf Puka, shoqëruar nga 7 vepra arti me tapa plastike.				
"Mbill pemën tënde!"-nisma e Rektorit të UAMD-së, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi në bashkëpunim me Kryebashkiaken e Durrësit, znj. Emiriana Sako dhe shkollat e Durrësit	770	550 fidanë e pemë u mbollën në kampusin e UAMD-së, sikurse mbi 170 rrënjë ullinj, mbi 120 eukalipt, mbi 70 pemë të larta rrap, agrume, plep e shkurte të tjera zbukuruese, kurse mbi 220 të tjera u mbollën në oborret e 35 shkollave të Durrësit. Dy shkollave u sigurua edhe tapet bari.				
Vepra arti nga riciklimi pranë kampusit të UAMD-së, Fakulteti i Edukimit.	2	1. Vepra e artit "Pema e Jetës" si bashkëpunim i Artistes Malvina Dreni me shkollat dhe Universitetin e Durrësit. Punimi me 1000 tapa të shisheve dhe sipër me epoxy resine. 2. Vepra e Artit, "Pema që ka rrënjë edukimin, fryt i një Shqipërie të pastër". "Edukimi, sikurse një pemë që ka rrënjë të thella, zhvillohet dhe rritet përmes ndikimit tonë si mësues për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e plastikës. Ky punim me 5000 tapa lidh edukimin dhe pastrimin e mjedisit me rolin e mësuesve si themelues të vlerave për një shoqëri të qëndrueshme."-shprehet mësuesja virtuozë Marsida Mezja e klasës Vc, shkolla "Bajram Curri", e cila e ndërtoi veprën dhe e dhuroi për UAMD-në.				
Promovim Filmi në Shtëpinë e Evropës dhe Kampusin e UAMD-së	2	1. Filmi për Ditën e Mjedisit, 5 Qershor 2024: "Kokrrat e piperit dhe sekreti i detit të thellë", në Shtëpinë e Evropës. 2. Filmi me metrazh të shkurtër "Dje dhe Sot", në kampusin universitar me rastin e 80 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Ky film bazuar në filmin e mirënjohur "Tomka dhe shokët e tij", reflekton mbi të kaluarën, duke treguar përpjekjet dhe sakrificat e atyre që kontribuan në çlirimin e Shqipërisë, si dhe për të pasqyruar zhvillimet e mëtejshme të shoqërisë shqiptare. Producente Marsida Mezja.				
Udhëtim me Anije	2	1. "Festë Deti 2024" me rimorkiatorin "Epidamn", i cili shëtitë bregdetin e Gjirit të Durrësit me më shumë se 100 të ftuar, organizuar nga shoqata "Durrësi Autokton". 2. Udhëtim me Katamaran rreth Kalasë në Porto Palermos, suportuar nga violinisti durrsak me famë Botërore Olen Çezari.				
Trashëgimi Kulturorë e vizituar	1	Kalaja në Porto Palermo, Himarë				
Parqe natyrore të vizituara	1	Parku natyror "Qafështamë", Krujë				
Bregdet, zonë e mbrojtur		Hamallaj, Gjiri i Lalëzit				
Artistë	3	Olen Çezari, violinistio me fame botërore, Malvina Dreni, Marsida Mezja				
Noterë që suportuan	1	Aida Spahiu- notere Durrës				
Shtëpia e Evropës, BE	1	Aktivitete për Riciklim dhe Edukim Mjedisor me 12 shkolla të Durrësit				
Kompani private të gjelbra që suportuan aktivitetet me shëbime, të ardhura apo gjelbërim	16	Electric.cars, Alb Uji, Resto_cafe_hotel_heming_way, Studio Parruca, Eco Soft Albania, Green Farm Albania, Fidanishte Xhepi, Agrofidane_Prenci, Tapet Bari-Vëllezërit Shehi, fidanishte_saimir_shahu, fidanishte_hushi, Lule_natyrale_hida, lule_natyrale_durimi, fidane.trendafila.tahiri, tapet_bari_natyral_lushnje				
Organizata	2	Durrësi Autoktone, Environmental and Territorial Management Institute (ETMI)				
Qeveria Lokale dhe Qendrore, Parlamenti	4	Bashkitë: Durrës, Krujë, Himarë, Agjencia e Zonave të Mbrojtura Durrës, Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Deputetë të Durrësit, Ministra				
Media	5	Top Channel, Euronews, Durrës Lajm, Ora news, Adria Tv etj				
Të ardhura nga shishet plastike (PET) të ricikluara. Transporti nga shkollat dhe UAMD në Kompani Riciklimi-Shkozë, u realizua falas nga Bashkia Durrës.					86,360 Lek	
Të ardhura nga kompanitë private dhe organizatat (si shërbime nuk janë përfshirë)					241,300 Lek	
Të ardhura nga Shtëpia e Evropës (si shërbime nuk janë përfshirë)					250,000 Lek	
Buxheti total, 2024					577,660 Lek	
Përqindja e të ardhurave nga Riciklimi nga buxheti total 2024					14.95%	

Tabela: Përqindja e 15 artikujve/ sendeve më të përhapura në Grykëderdhjen e Ishmit.

	Tipi i Materialit	Kodi	Emri i artikujve/sendeve	%
1	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G8	Shishe pijesh >0.5l	33.9
2	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G7	Shishe pijesh <=0.5l	30.9
3	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G9	Shishe dhe kontenierë për higjienë dhe pastrim	9.8
4	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G33	Gota plastike dhe kapakët e gotave	6.7
5	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G102	Shapka me gisht/pandofla plastike	4.8
6	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G21	Kapakë plastike/kapakë pijesh	4.3
7	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G12	Shishe dhe kontenierë të tjerë kozmetikë	2.9
8	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G71	Këpucë/ sandale	2.1
9	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G82	Copa polistireni (ose bukë peshku) 2.5 cm > < 50cm	1.1
10	XHAM/QERAMIKË	G200	Shishe, pjesë shishesh	1.1
11	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G100	Kontenierë farmaceutikë/mjekësorë/tuba	0.62
12	RROBA/TEKSTIL	G138	Këpucë dhe sandale (p.sh. lëkurë, rroba)	0.34
13	MATERIAL POLIMER ARTIFICIAL	G28	Stilolapsa dhe kapakë stilolapsi	0.26
14	LETËR/KARTON	G151	Kuti kartoni/Tetrapack (të tjera)	0.24
15	METAL	G175	Kanaçe (pije)	0.18

*Studimet e mbetjeve të lumit u kryen në përputhje me udhëzimet operacionale të prodhuara nga Grupi Teknik i BE-së MSFD mbi mbetjet detare dhe të përshkruara nga Galgani et al. (2013).



Link-e nga media kombëtare dhe lokale mbi aktivitetet e 2024:

Euro News- Dita botërore e Tokës :<https://www.youtube.com/watch?v=U3FFIEkrGOW>
 Top Channel,-Dita Botërore e Ujit/ Marsh sensibilizimi në Durrës për riciklimin e plastikës:
https://www.youtube.com/watch?v=LwCitdC_pJg
 Euro News <https://www.youtube.com/watch?v=Y2HJ-k4rNys>
 Durrës lajm: <https://www.youtube.com/watch?v=x5-nwQQDcqA>
 Mbledhja e shisheve dhe tapave plastike: Ndërgjegjësimi për një mjedis të pastër
<https://www.youtube.com/watch?v=Z1T-wmIwL-8>
 Durrës Lajm: River Cleanup aksion pastrimi në shëtitore:
<https://www.youtube.com/watch?v=Dyl1XLs36qk>